



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 115

Prishtinë, më 11.7.2024, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Hajdar Beqa.

**Munguan:** Blerta Deliu-Kodra, Besnik Tahiri dhe Driton Selmanaj.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Te ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Ema Krasniqi, KDI;

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24. 5 dhe 6.6.2024;
3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/l-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-295 për krypto-asetet;
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetari**, konstatoi se, u miratua rendi i ditës.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 24.5 dhe 6.6.2024;**

**Kryetari**, konstatoi se u miratuan procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më: 24.5 dhe 6.6.2024, pa ndryshime.

**3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;**

Meqë nuk pati diskutime kryetari konstatoi se, Komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'i rekomandohet për lexim të dytë, Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;

**4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit;**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ai sqaroi se Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me shtatë vota për, u miratua Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:*

**Rekomandim**

1. Projektligji nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-295 për kriptu-asetet;**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-295 për kriptu-asetet. Ai tha se Komisioni për Legjislacion në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me gjashtë vota për dhe një abstenim, u miratua Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:*

## **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 08/L-295 për krypto-asetet dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **6. Të ndryshme.**

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----